



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KRYETARI

Nr. 10012/11 prot

Fier, më 18 . 09 . 2026

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

BANORËVE TË KOMUNITETIT TË FIERIT DHE GJITHË PALËVE TË
INTERESUARA

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, nenit 9, pika 1.3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 18 të rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike, si dhe në vijim të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë (Sekretari i Përgjithshëm) nr. 3573 prot., datë 31.07.2026,

Ju njoftojmë se do të zhvillohen dëgjesa publike në kuadër të:

- **PROPOZIMIT TË PROJEKTLIGJIT «PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË »**

Ky proces ka si qëllim informimin e popullatës dhe mbledhjen e mendimeve, sugjerimeve dhe argumenteve mbi modelin e ri të propozuar të organizimit të brendshëm të bashkive (Bashki – Qytet – Njësi Administrative), për të garantuar një përfaqësim sa më të mirë dhe shërbime më pranë qytetarit.

Ftojmë të gjithë grupet e interesit: qytetarë, biznese, fermerë, grupe të marginalizuara, të rinj, shoqëri civile dhe ekspertë të fushës, të bëhen pjesë e këtij procesi transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimet do të zhvillohen sipas kalendarit të mëposhtëm:

Nr	Fshatrat e takimit	Dita e takimit	Data e takimit	Vendi	Ora

1	Cakran	E martë	15.09.2026	Qendër	11:00
2	Frakull	E martë	15.09.2026	Qendër	13:00
3	Levan	E martë	15.09.2026	Qendër	14:30
4	Qëndër	E mërkurë	16.09.2026	Qendër	10:00
5	Dërmënas	E mërkurë	16.09.2026	Qendër	11:30
6	Topojë	E mërkurë	16.09.2026	Qendër	13:00
7	Libofshë	E enjte	17.09.2026	Qendër	12:00
8	Mbrostar	E enjte	17.09.2026	Qendër	14:30
9	Portëz	E enjte	17.09.2026	Qendër	11:00
10	Rajonet e Qytetit (Fier)	E premte	18.09.2026	Qendër	12:30

Këto takime kanë si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve të cilat do t'i përcillen zyrtarisht Kuvendit të Shqipërisë, si pjesë e procesit të konsultimit për Reformën

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të emailit :

[Neritan.Bocova@bashkiafier.gov.al](mailto: Neritan.Bocova@bashkiafier.gov.al) Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Këto dëgjesa do të zhvillohen në bashkëpunim me Bashkinë dhe , Antarë / përfaqësues të Këshillit Bashkiak Fier,

Pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme për të ardhmen e komunitetit tonë!!

KRYETAR
Armando SUBASHI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Nikollaq Neço

